



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall: **Konkurs me Marrëveshje për Shërbime të Veqanta**

KONKURS

Titulli i pozitës: Zyrtar Ligjor

Njësia Organizative: Drejtoria e Administratës së Përgjithëshme - AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Marrëveshje për Shërbime të Veqanta për gjashtë (6) muaj.

Koeficienti: 7

Qëllimi i vendit të punës Hartimi, zhvillimi dhe harmonizimi i legjislacionit dhe akteve tjera juridike si dhe dhënia e këshillave për menaxhmentin dhe njësitë organizative të agjencis .

Detyrat kryesore:

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të Agjencis dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;10%
2. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të sektorit dhe harton raporte mbi progresin e arritur si dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohen;10
3. Bën hulumtime dhe analiza që ndërlidhen me aktet normative brenda fushës së përgjegjësisë së Agjencionit dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e Agjencis; 15%
4. Udhëheq grupet punuese për hartimin dhe zhvillimin e legjislacionit primar dhe sekondar dhe ndihmon stafin tjetër të Agjencis për hartimin e legjislacionit si dhe siguron që përmbajtja dhe forma e projekt akteve normative të jetë e saktë dhe identike në gjuhët zyrtare ; 20 %
5. Siguron pajtueshmërinë e projektligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore me Kornizën Kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe merr pjesë në hartimin e strategjisë legjislative të Agjencisë; 15%
6. Harton aktet tjera juridike, kontrata, marrëveshje nga fushë veprimtaria e Agjencisë, metodologji dhe procedura për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit si dhe jep opinione ligjore; 15%
7. Kryen raportet javore ,muajore lidhur me sektorin e Ligjor; 10%

Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi; 5%

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma universitare, fakulteti juridik minimum 1 vite përvojë pune profesionale;

- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së agjencionit;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Data e shpalljes së konkursit me: **27.05.2019**

Data e mbylljes së konkursit me: **03.06 .2019**

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 16 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së www.azhb-ks.net.